



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë 04 qershor 2008, nenit 6 pika 1 paragrafi 1.2, nenit 21 paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 24 nenit paragrafi 3, nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës datë 13.08.2020, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021 dhe duke u bazuar në shkresën përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.020-309/8 datë 15.05.2023 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.05.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE GRACKË E VJETËR

Neni 1

1. Me këtë Vendim, i jepet në shfrytëzim për periudhën afatëgjatë prej 20 vitesh, prona komunale për ndërmarrjen-kompaninë publike Regjionale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Sh.A- Prishtinë, në parcelën kadastrale P-71409080-00256-0 me sipërfaqe prej 6570 m² me kulturë kullosë e klasës 3-të zona kadastrale Grackë e Vjetër, sipas kërkesës së datës 18.05.2023 ref 15Nr.462/01-25601 të Kompanisë Regjionale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" Sh.A -Prishtinë.

Neni 2

Qëllim i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi është për ndërtimin e infrastrukturës teknike në ofrimin e shërbimeve administrative dhe shërbimeve të tjera si dhe për vendosjen e makinerisë për ushtrimin e veprimtarisë, që të krijohen kushtet (teknike) për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj qytetarëve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronësores-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Inspektion dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi fshihet pika 1.2 e nenit 1 të Vendimit 15Nr.463-44897 të datës 20.07.2018 për caktimin e lokacionit për vendosjen e tregut të kafshëve dhe vendosjen e tregut për produktet ushqimore për kafshë dhe lëndë djegëse në ZK Grackë e Vjetër dhe SHFUQIZOHET Vendimi 15Nr.463-44904 të datës 20.07.2018 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës Kompanisë Regjionale Pastrimi-Prishtinë, Njësia Operative në Lipjan.

15 Nr. 463/02-27906

Lipjan, më 31.05.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

